



UNIVERSITETI
POLITEKNIK
I TIRANËS

GUIDA STUDENTORE

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS '25-'26



MIRËSEERDHËT

NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

GUIDA STUDENTORE UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Universiteti Politeknik i Tiranës
Guida studentore / Universiteti Politeknik i Tiranës. - Tiranë: Universiteti Politeknik i Tiranës, 2025.
68 f. ; 14.8 x 21 cm.

ISBN 978-9928-4814-4-3

1.Universiteti Politeknik i Tiranës 2.Studentë të universiteteve dhe kolegjeve 3.Guida
37 .091.6(496.5) (036)

© Universiteti Politeknik i Tiranës 2025 - Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Falënderime

Guida studentore është një prodhim i nisur nga një grup studentësh, pjesë e Universitetit Politeknik të Tiranës në bashkëpunim me Universitetin Politeknik të Tiranës. Një falenderim i veçantë shkon për ndihmën e pakushtëzuar të Rektoratit dhe specifikisht Zyrës së Karrierës e Drejtorisë të Komunikimit dhe Koordinimit në Universitetin Politeknik të Tiranës, që mundësuan mbështetjen, mbledhjen e informacionit, kontaktet dhe realizimin grafik të këtij projekti. Grupi i punës i studentëve, i angazuar për finalizimin e këtij projekti:

Altena Qyrku	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Studente
Aurela Kalthi	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Alumni
Andri Çepi	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Student
Artenisa Kërçyku	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Studente
Burhan Misiraj	Fakulteti i Teknologjisë dhe Informacionit, Alumni
Erjon Doçi	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Alumni
Fatime Selimaj	Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, Studente
Fjoresilda Hatellari	Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, Alumni
Ilda Lekgegaj	Fakulteti i Teknologjisë dhe Informacionit Studente
Izmir Xhafa	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike, Alumni
Klaudja Bezati	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Studente
Valbona Halitaj	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Alumni
Altea Kënuti	Fakulteti i Teknologjisë dhe Informacionit, Studente
Realdo Malaj	Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, Student
Erlini Qordja	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Student
Alesja Bakijasi	Fakulteti i Teknologjisë dhe Informacionit, Studente

Terminologjia e përdorur:

UPT - Universiteti Politeknik i Tiranës
FIM - Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
FIE - Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike
FIN - Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit
FTI - Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit
FGJM - Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave
FIMIF - Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike
FAU - Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës
IGJEO - Instituti i Gjeoshkencave

Bibliografia:

Faqja zyrtare e Universitetit Politeknik të Tiranës / web
Faqja zyrtare e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit / web
Faqja zyrtare e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike / web
Faqja zyrtare e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike / web
Faqja zyrtare e Fakultetit të Inxhinierisë së Gjeologji-Minierave / web
Faqja zyrtare e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit / web
Faqja zyrtare e Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës / web
Faqja zyrtare e Bashkisë së Tiranës / web
Agjencia Kombëtare e Turizmin / web
Ligji për Arsimin e Lartë Statuti UPT
Broshura informative e UPT-së
Broshura informative e rezidencave studentore shtetërore RSU

PËRMBAJTJA

Letra e mirëseardhjes	06	Këshilla nga studentët për studentët	45
Kapitulli 1		Kapitulli 3	
Njohja me qytetin e Tiranës	08	Tarifat e studimit	46
		3.1 Tarifat në Universitetin Politeknik të Tiranës..	47
		a. Tarifat e regjistrimit për programet në Universitetin Politeknik të Tiranës për vitin akademik 2025-2026	47
		b. Tarifat e Shkollimit në programet e studimeve të ciklit të parë Bachelor për vitin akademik 2025-2026	47
		c. Tarifat e shkollimit në programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave ” për vitin akademik 2025-2026	49
		d. Tarifat e shkollimit në programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Profesional” për vitin akademik 2025-2026	52
		3.1.1 Pagesat e tarifave	53
		3.1.2 Bursat e studentëve	53
Kapitulli 2		Kapitulli 4	
Universiteti im	10	Student në Universitetin Politeknik	56
2.1 Historiku i Universitetit Politeknik të Tiranës	11	4.1 Të drejtat dhe detyrat e studentit	57
2.2 Struktura Organizative Institucionale	13	4.2 Karta e studentit	58
2.3 Sistemi universitar	14	4.3 Rezidencat studentore në Tiranë	58
2.3.1. Programet e studimit me karakter profesional	14	4.4 Bibliotekat e qytetit të Tiranës	61
2.3.2. Programet e Ciklit të parë të studimeve ...	14	4.5 Sportet në Universitetin Politeknik	62
2.3.3. Programet e Ciklit të dytë të studimeve ...	14	4.6 Transporti publik në Tiranë	63
2.4 Struktura në mbështetje e shërbim të studentëve	16		
2.4.1. Zyra e Këshillimit të Karrierës	16	Kapitulli 5	
2.4.2. Sekretaria mësimore	18	Platformat online	64
2.4.3. Biblioteka Shkencore e UPT-së	19	Microsoft Teams	65
2.5 Kërkimi shkencor në UPT	20	Platforma E-Learning FAU	66
2.5.1. Kërkimi shkencor	20	Platforma Bit-Albania	66
2.5.2. Programet e studimit të Ciklit III	20		
2.6 Ndërkombëtarizimi	21	Kontakte të rëndësishme	67
2.6.1. Fonde të Bashkimit Europian në UPT	21		
2.6.2. Projekte në kuadër të rritjes së kapaciteteve	21		
2.6.3. Mobilitetet studentore Erasmus (KA1)	22		
2.6.4. Diplomati e dyfishta	28		
2.7. Njësitë përbërëse të Universitetit Politeknik	29		
Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës (FAU) ..	30		
Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit (FIN)	32		
Fakulteti i Inxhinierisë Matematike & Inxhinierisë Fizike (FIMIF)	34		
Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave (FGJM) ..	36		
Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit (FTI)	38		
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (FIM)	40		
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike (FIE)	42		
Instituti i Gjeoshkencave (IGJEO)	44		

Të dashur studentë,

Së pari ju falenderojmë që zgjedhët Universitetin Politeknik të Tiranës për të ndërtuar dhe formuar rrugëtimin tuaj jetësor. Në qendër të misionit të tij janë interesat dhe pasionet e të gjithëve ne, që punojmë dhe studiojmë këtu çdo ditë, si edhe aktivitetet kërkimore dhe akademike që synojnë të zgjerojnë horizontet tona kulturore dhe intelektuale, duke na përgatitur si liderët e ardhshëm të shoqërisë.

Me shumë kënaqësi ju prezantojmë këtë guidë studentore, e cila është përgatitur nga studentët për studentët. Këtë guidë e kemi krijuar për t'ju ndihmuar të orientoheni më lehtë dhe të përfitoni sa më shumë nga eksperiencia juaj akademike këtu.

Vitet e jetës studentore janë të rëndësishme për të ndërtuar një bagazh të vlefshëm kompetencash që do t'i përdorni në karrierën tuaj të ardhshme.

Por, mbi të gjitha, dëshirojmë që këto vite të jenë për ju një mundësi unike për zhvillim personal dhe ndërtim marrëdhëniesh të qëndrueshme.

E dimë se të regjistrohesh në universitet është një zgjedhje vendimtare, një investim për të ardhmen. Ndaj urojmë që nëpërmjet studimeve që keni zgjedhur të kryeni, duke pasur edhe mbështetjen tonë, të përfitoni nga çdo mundësi që ofron ky institucion e të gjeni mënyrën e duhur për të shprehur maksimalisht potencialin tuaj.

Ju urojmë sa më shumë suksese në udhëtimin tuaj akademik dhe mirë se vini në familjen tonë universitare!

Përzemërsisht,
Studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës



01

NJOHJA ME QYTETIN E TIRANËS

Tirana, kryeqyteti i rinisë

Tirana është kryeqendra e qarkut dhe rrethit me të njëtin emër, dhe kryeqyteti i Republikës së Shqipërisë. Është qyteti më i madh i Shqipërisë dhe njëkohësisht qendra më e madhe ekonomike, administrative, politike, industriale, mediale, akademike, sociale dhe kulturore e vendit.

Tirana është një qytet shumëngjyrësh, dhe ofron një gamë destinacionesh që nuk duhen humbur:

Sheshi Skënderbej - qendra historike e Tiranës, e cila bën bashkë tre monumente ikonike, të cilat përfaqësojnë kryeqytetin tonë: busti i Skënderbeut, Sahati i Tiranës dhe Muzeu Historik Kombëtar.

Piramida e Tiranës - e ndërtuar fillimisht si muze kushtuar diktatorit, në vitet '80, sot është transformuar në Qendrën e Inovacionit dhe Kapacitetit Teknologjik të qytetit, ku ndodhen zyrat e disa *startup*-eve, qendra TUMO, dhe shumë ambiente rekreative.

Parku i madh i Liqenit Artificial të Tiranës - parku kryesor i gjelbëruar i qytetit dhe vendpushimi i preferuar i vendasve dhe i turistëve.

Kalaja e Tiranës - një hapësirë në shërbim të promovimit të trashëgimisë kulturore e materiale, ndërtuar në afërsi të kalasë së vjetër të Tiranës, ku ndërthuret e vjetra me modernen, kulinaria dhe artizanati.

Pazari i Ri - një nga lagjet më të vjetra të kryeqytetit, i cili e ka marrë emrin nga tregu i ushqimeve që ndodhet në këtë zonë. Këtu gjenden larmishmëri frutash, perimesh, mishi, ushqimesh deti dhe erëzash tradicionale shqiptare, si edhe ambiente të shumta çlodhëse e rekreative.

Mali i Dajtit - pjesë e panoramës turistike të kryeqytetit, i cili ofron një pamje mbresëlënëse dhe një seri aktiviteteesh si ngjitje/hiking/lojra rezistence 1600 metra mbi nivelin e detit.

Aplikacioni **Tirana ime** është një udhëzues digjital për kryeqytetin, të cilin mund ta shkarkoni në AppStore.



02

UNIVERSITETI IM

2.1 HISTORIKU I UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS

1951

Themelohet **Instituti i Lartë Politeknik në Tiranë**, i cili përmbante degën e **Inxhinierisë Mekanike**, degën e **Inxhinierisë Elektrike** dhe degën e **Inxhinierisë së Ndërtimit**.

Stafi i tij akademik përbëhej fillimisht nga pedagogë rusë dhe asistentë shqiptarë, të diplomuar në fakultetet inxhinierike, kryesisht të vendeve të Europës Lindore. Me rritjen e nivelit të kualifikimit dhe të specializimit të pedagogëve shqiptarë, erdhi dhe zëvendësimi i plotë i pedagogëve të huaj.

1957

Si pjesë përbërëse e Universitetit Shtetëror të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë përfshinte degën e **Inxhinierisë Mekanike**, degën e **Inxhinierisë Elektrike**, degën e **Inxhinierisë së Ndërtimit** dhe degën e **Gjeologji-Minierave**, në të cilat diplomoheshin inxhinierë të përgjithshëm sipas katër fushave përkatëse inxhinierike.



1971

Përfundon ristrukturimi i parë i programeve të studimit, si dhe në këtë periudhë bëhet i mundur kualifikimi i stafit akademik jashtë vendit, duke sjellë rezultate të shkëlqyera për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në universitet.



1991

Formohet **Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT)** duke u shpëputur nga Universiteti i Tiranës. Kjo bën të mundur krijimin e katër fakulteteve: **Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (FIM)**; **Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike (FIE)**; **Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit (FIN)**; **Fakulteti i Gjeologji-Minierave (FGJM)**.

Në këtë kuadër ndërtohen programe të reja studimi dhe rritet numri i drejtimeve të tyre.

1994

Ndryshon struktura organizative e fakulteteve të **Universitetit Politeknik të Tiranës**: krijohen departamentet, të cilët detajohen deri në seksione.



2005

Ristrukturohen programet e studimit të Universitetit Politeknik të Tiranës, bazuar në "Deklaratën e Bolonjës", dhe fillon zbatimi i programeve të studimit në dy cikle: në ciklin **3-vjeçar - Bachelor** dhe në ciklin pasues **2-vjeçar - Master**, të ndarë në: **Master Profesional** dhe **Master i Shkencave**.

2007	2009	2011	2013
Universiteti Politeknik i Tiranës ka 6 fakultete. Përveç katër fakulteteve ekzistues krijohen Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit (FTI) dhe Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike (FIMIF).	Fillon implementimi i programeve të studimit të Ciklit të tretë 3-vjeçar Doktoratë.	Në bazë të Ligjit “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” Nr. 9741, Dt. 21.05.2007, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës u vendosen dy institute: Instituti i Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (INEUM) dhe Instituti i Gjeo-Shkencës (INGJSH), të cilët bashkohen duke krijuar Institutin e Gjeoshkencave (IGJEO).	Krijohet fakulteti i shtatë, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës (FAU), duke u veçuar nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit.

2.2 STRUKTURA ORGANIZATIVE INSTITUCIONALE

2.2.1. Senati Akademik Senati Akademik është organ kolegjal vendimmarrës i zgjedhur në nivel universiteti. Veprimtaria e Senatit të UPT-së, mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Senati është organi më i lartë i universitetit që përcakton politikat e zhvillimit të tij, programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor, problemet administrativo-financiare si dhe vlerëson efikasitetin e tyre. Senati akademik kryesohet nga Rektori, i cili është kryetar i tij dhe përbëhet nga 37 anëtarë të brendshëm, të zgjedhur si përfaqësues të grupeve përkatëse të universitetit sipas nenit 9, pika 4, të statutit të UPT, + 1 (Rektori). Ndër ta, 4 anëtarë janë studentë të zgjedhur unanimisht nga studentët e UPT-së.	2.2.2. Bordi i Administrimit Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të Universitetit Politeknik të Tiranës, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij. Rektori dhe Administratori i institucionit kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e Bordit të Administrimit, pa të drejtë vote, kur e vlerësojnë ata vetë, si dhe kur thirren nga ky bord. Bordi i Administrimit përbëhet nga 7 anëtarë: • Përfaqësues të zgjedhur nga UPT (3 anëtarë) • Të emëruar nga Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, përfaqësues nga fushat akademike, menaxheriale, ekonomike dhe juridike (4 anëtarë)
---	---

Universiteti Politeknik i Tiranës në shifra 2024-2025



13500 (afërsisht) Studentë të regjistruar	rrreth 10000 Studentë në ciklin e parë të studimeve, Bachelor
rrreth 2400 Studentë në ciklin e dytë të studimeve, Master Shkencor dhe Master Profesional	rrreth 1300 Studentë në Programet e Integruara të Studimit të ciklit të dytë
rrreth 120 Studentë në ciklin e tretë të studimeve, Doktoratë	366 Staf akademik dhe kërkimor-shkencor.
230 Staf administrativ dhe staf ndihmës akademik.	

STRUKTURA DREJTUESE E REKTORATIT TË UPT-së Rektor: Prof. Dr. Akli Fundo aklifundo@upt.al Administrator: Besmir Ali ali.besmir@upt.al Zv. Rektor për anën Shkencore: Prof. Dr. Elfrida Shehu elfridashehu@upt.al	Studentët anëtarë në Senatin Akademik Altea Kënuti Studente pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit në degën Inxhinieri Informatike. E zgjedhur si përfaqësuese e studentëve, përkushtohet maksimalisht për të përfaqësuar interesat e tyre si edhe për të krijuar një ambient akademik frymëzues dhe bashkëpunues. Kontakt: altea.kenuti@fti.edu.al Realdo Malaj Student në vitin e katërt në Universitetin Politeknik të Tiranës, në degën e Arkitekturës, në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës. Kontakt: realdomalaj@gmail.com Erlini Qordja Student në vitin e tretë në Inxhinieri Ndërtimi, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit. Kontakt: erlini.qordja@fin.edu.al Alesja Bakijasi Studente në vitin e dytë në Universitetin Politeknik të Tiranës - Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit. Kontakt: alesjabakijasi13@gmail.com
---	---

2.3 SISTEMI UNIVERSITAR

2.3.1. Programet e studimit me karakter profesional

Institucionet e arsimit të lartë mund të ofrojnë programe studimi me karakter profesional, pas arsimit të mesëm, me 60 ose 120 kredite formimi, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Kohëzgjatja e tyre normale është një ose dy vite akademike dhe në përfundim lëshohet respektivisht “Certifikatë profesionale” ose “Diplomë profesionale” në fushën e arsimimit të kryer.

Kreditet e grumbulluara gjatë studimeve profesionale të larta mund të transferohen në studimet e ciklit të parë, që referohet në nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, sipas kriterëve të përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë.

2.3.2. Programet e Ciklit të parë të studimeve

Programet e ciklit të parë të studimit, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohen me jo më pak se 180 kredite evropiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është tre vite akademike.

Studentët në programet e ciklit të parë të studimeve diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome. Institucionet e arsimit të lartë përcaktojnë në rregulloren e tyre prapun e notës mesatare, që i jep të drejtë studentit të ciklit të parë të diplomohet, duke përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome.



Skema e programeve te studimit në UPT

Në përfundim të programeve të ciklit të parë lëshohet diploma “Bachelor” në fushën e arsimimit të kryer.

Pranimi në ciklin e parë të studimeve

Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Institucionet e arsimit të lartë mund të vendosin edhe kriteret shtesë pranimi për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilat shpallen nga Institucioni i Arsimit të Lartë dhe vihen në dispozicion të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Në fillim të vitit akademik, Institucionet e Arsimit të Lartë dërgojnë në Qendrën e Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar.

2.3.3. Programet e ciklit të dytë të studimeve

Cikli i dytë i studimeve përfshin programet e studimit “Master i Shkencave”, “Master i Arteve” dhe “Master Profesional”, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Të gjitha kriteret dhe modalitetet e fitimit të diplomave “Master i Arteve” janë të njëjta me ato për fitimin e diplomës “Master i Shkencave”, me ndryshimin që diploma “Master i Arteve” lëshohet nga Institucione të Arsimit të Lartë, që ofrojnë formime në fushën e arteve.

a. Programet e studimit “Master i Shkencave”

pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike, si edhe me aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar. Këto programe organizohen në:

1. Programe që realizohen me jo më pak se 120 kredite formimi në vijim të ciklit të parë dhe me kohëzgjatje normale dy vite akademike;

2. Programe të integruara të studimeve të ciklit të dytë, që realizohen me 300 dhe 360 kredite dhe me kohëzgjatje normale respektivisht 5 dhe 6 vite akademike. Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ofrohen në fushat e drejtësisë, mjekësisë, të stomatologjisë, të farmacisë, të veterinarisë e të arkitekturës. Këshilli i Ministrave përcakton fusha të tjera, në të cilat mund të ofrohen programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Studimet e ciklit të dytë “Master i Shkencave” përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master i Shkencave” në fushën e arsimimit të kryer.

b. Programet e studimit “Master i Arteve”

pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, në fushën e arteve. Këto programe realizohen me jo më pak se 120 kredite formimi në vijim të ciklit të parë dhe me kohëzgjatje normale dy vite akademike.

c. Programet e studimeve “Master Profesional”

pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara, profesionale në një fushë të caktuar.

Këto programe organizohen me 60 ose 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit ose dy vite akademike. Studimet e ciklit të dytë “Master Profesional” përmbyllen me provim përfundimtar formimi ose punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master Profesional” në fushën e arsimimit të kryer.

Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve

Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë

përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimi të institucionit të arsimit të lartë ku ata aplikojnë.

Pranimi në programet e integruara të studimeve është i mundur për kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 1, të nenit 74, të këtij ligji. Kriteret e pranimi të kandidatëve në programet e ciklit të dytë të studimeve përcaktohen nga njësia bazë ofruese e programit. Bëjnë përjashtim nga ky rregull programet e integruara të studimit. Kriteret bëhen publike nga njësia kryesore dhe QSHA-ja dhe miratohen sipas përcaktimeve në statutin e IAL-së.

Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të dytë “Master i Shkencave” është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Nëse individ ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj përcaktohet me akt nënligjor të ministrisë përgjegjëse të arsimit të lartë.

Institucionet e Arsimit të Lartë mund të njohin kredite të përfituara në programet e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional”, me qëllim transferimin e tyre në programet e studimit “Master i Shkencave”.

Në fillim të vitit akademik, institucionet e arsimit të lartë dërgojnë në QSHA listën e studentëve të regjistruar.

Universiteti Politeknik i Tiranës zbaton programin e Kartës së Bolonjës (3+2).

Ofrohen studime të ciklit të parë Bachelor, të ciklit të dytë Master i Shkencave dhe Profesional, si dhe Programe të Integruara të Studimeve të Ciklit të Dytë.

Universiteti Politeknik i Tiranës ofron gjithashtu studime të ciklit të tretë - Doktoratë - në të gjitha fakultetet përbërëse të saj.

2.4 STRUKTURA NË MBËSHTETJE E SHËRBIM TË STUDENTËVE

2.4.1. Zyra e Këshillimit të Karrierës

Zyrat e Këshillimit të Karrierës në Rektorat dhe Fakultete ofrojnë një gamë të gjerë shërbimesh për studentët dhe të diplomuarit e Universitetit Politeknik të Tiranës, të cilat kanë për qëllim orientimin e edukimit profesional, lehtësimin e zhvillimit të karrierës, përgatitjen për tregun e punës dhe mbështetje për të vazhduar aftësimin e tyre profesional nëpërmjet të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Misioni i Zyrës së Karrierës në Universitetin Politeknik të Tiranës është të mbështesë dhe të udhëheqë studentët dhe alumni-t në zhvillimin e planeve të tyre të karrierës, duke u ofruar shërbime dhe burime që i përgatisin për të hyrë me sukses në tregun e punës dhe për të arritur qëllimet e tyre profesionale.

Vizioni i Zyrës së Karrierës në Universitetin Politeknik të Tiranës është të jetë një qendër e njohur dhe e besuar për zhvillimin e karrierës, e cila fuqizon studentët dhe alumni-t të arrijnë potencialin e tyre të plotë profesional dhe personal në një treg global pune.

Zyra e Karrierës në Universitetin Politeknik të Tiranës është e angazhuar për të ndihmuar studentët dhe alumni-t të arrijnë sukses në karrierën e tyre duke ofruar një gamë të gjerë shërbimesh dhe mbështetje.

Këto shërbime janë:



Orientimi i edukimit profesional



Zhvillimi i karrierës



Përgatitje për tregun e punës



Mbështetje për aftësimin profesional

Na shkruaj për më shumë informacion në:

ZYRA E KARRIERËS DHE ALUMNI-T NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

Godina e Rektoratit, Kati I
zyraekarrieres@upt.al

ZYRAT E KARRIERËS NË FAKULTETE

FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE
jamiti@fim.edu.al

FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE
irida.balla.fie@upt.al

FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT
irena.katij@fin.edu.al

FAKULTETI I GJEOLGJISË DHE MINIERAVE
melisa.bozhanaj@fgjm.edu.al

FAKULTETI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT
sbylyku@fti.edu.al

FAKULTETI I INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE
r.ramaj@fimif.edu.al

FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS
zeqiraj.marsilda@hotmail.com


Shërbimet të tjera që ofron Zyra e Këshillimit të Karrierës janë:



Identifikimi dhe informimi mbi mundësitë edukative (bursa, trajnime, etj.)



Këshillim karriere nëpërmjet vlerësimit të interesave, vlerave dhe aftësive profesionale



Trainime për zhvillimin e aftësive që rrisin mundësitë e futjes së të diplomuarve në tregun e punës



Informimi dhe **promovimi i ofertave të internship-eve**, vendeve të punës, etj.



Këshillimi i studentëve të UPT-së që diplomohen në Ciklin e Parë për mundësitë e studimeve në Ciklin e Dytë në UPT ose universitete të tjera jashtë vendit



Mbajtja e kontaktit me alumnët dhe ndërthurja e kërkesave dhe ofertave të edukimit gjatë gjithë jetës



Lidhja aktive e vazhdueshme me kompanitë brenda e jashtë vendit si dhe vlerësimi i kërkesave të tyre për forcë pune



Aktivitete të ndryshme promovuese dhe informuese dhe **organizimi i përvitshëm i Panairit të Karrierës**




Informimi i maturantëve, studentëve të ardhshëm për programet e studimit, kriteret e pranimit dhe politikat e UPT-së

Përmes këtyre shërbimeve, Zyra e Karrierës në Universitetin Politeknik të Tiranës synon të fuqizojë studentët dhe alumni-t me mjetet dhe mbështetjen e nevojshme për të ndërtuar një karrierë të suksesshme dhe të qëndrueshme.

Universiteti Politeknik i Tiranës ka nënshkruar më shumë se **120 marrëveshje bashkëpunimi** me kompani vendase e të huaja në sektorin privat.









+300

Internships dhe praktika profesionale të ofruara çdo vit.

> 80%

Norma e punësimit për Alumni të Universitetit Politeknik të Tiranës

3 Edicione

Panairi i Karrierës

TRAJNIME

PRAKTIKA, GRANTE DHE INTERNSHIPE STUDENTORE

2.4.2. Sekretaria Mësimore

Sekretaria mësimore është një nga strukturat më të rëndësishme që **gjendet brenda çdo fakulteti të Universitetit Politeknik të Tiranës**. Sekretaria mësimore është një strukturë racionale e krijuar për të përmbushur sa më mirë detyrat e organizimit të procesit mësimor të fakultetit, në shërbim të studentëve dhe të stafit akademik. Roli i saj kryesor është mbarëvajtja e të gjithë aktiviteteve mësimore të fakultetit. Kjo strukturë është përgjegjëse për korrektësinë e plotësimit

dhe mbajtjes së dokumentacionit, si dhe të informimit të studentëve dhe stafit akademik.

Pranë sekretarive mësimore bëhet regjistrimi i studentëve të vitit të parë në regjistrin themeltar në bazë të listës së fituesve si dhe regjistrimi i studentëve të viteve të tjera. Këtu **studentët mund të marrin shërbim për plotësimin e vërtetimeve të ndryshme, librezat e notave, kartat e studentit**, etj.

INFORMACIONE TË RËNDËSISHME PËR STUDENTËT

Viti akademik përbëhet nga **2 semestra**, secili nga **14 javë në nivelin e studimeve Bachelor** dhe **12 javë në Nivelin e Studimeve Master**.



SEMESTRI 1



SEZONI 1
I PROVIMEVE
Sezoni i dimrit



SEMESTRI 2



SEZONI 2
I PROVIMEVE
Sezoni i verës



SEZONI 3
I PROVIMEVE
Sezoni i vjeshtës

KALIMI NË VITIN PASARDHËS

Në çdo vit mësimor të ciklit Bachelor zhvillohen lëndë, tërësia e së cilave përmban **60 kredite**. Për të kaluar në vitin e dytë studenti nevojitet të marrë **30 kredite**. Kalimi në vit të tretë kërkon **80 kredite nga të dy vitet paraardhëse**, pavarësisht përqindjes që zë viti i parë apo i dytë.

HYRJA NË PROVIME

Vetëm pasi studenti të ketë shlyer të gjitha detyrimet (provime + dorëzime detyrash) ka të drejtë të hyjë në provimin ose temën për mbrojtjen e diplomës.

PËRMIRËSIMI I NOTAVE

Pas mbarimit të sesionit të verës, studenti ka të drejtë të kërkojë në Sekretarinë mësimore të **përseritë 2 provime** të vitit që sapo përfundoi me qëllim **përmirësimin e notës**.

2.4.3. Biblioteka Shkencore e Universitetit Politeknik të Tiranës

Biblioteka e Universitetit Politeknik të Tiranës është një nga bibliotekat universitare më të pasura në vend, jo vetëm për nga krijimi dhe koleksionet e Bibliotekës së UPT-së, me literaturë bashkëkohore të profilit tekniko-shkencor, në shqip dhe në gjuhë të huaj që lidhet me realizimin e programeve të studimit por edhe për informimin, promovimin dhe kërkimin shkencor në nivel institucional.

Organizimi strukturor i Bibliotekës Shkencore, si njësi strukturore ndihmëse e Universitetit Politeknik të Tiranës përfshin **Bibliotekën e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Bibliotekën e Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave dhe Bibliotekën e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike**.



Biblioteka Shkencore e Universitetit Politeknik të Tiranës

Drejtore

MSc Mimoza Shkodrani
mshkodrani@upt.al

www.biblioteka-shkencore.edu.al

2.5 KËRKIMI SHKENCOR NË UPT

2.5.1. Kërkimi shkencor

Kërkimi shkencor në Universitetin Politeknik të Tiranës mbështetet në prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit dhe gërshetohet me mësimdhënien, me pikësynim rritjen e cilësisë së ofertës akademike. Universiteti Politeknik i Tiranës promovon kërkimin shkencor bazë dhe të zbatuar. Ai siguron koordinimin dhe zhvillimin e projekteve kërkimore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe nxit përfundimin e njohurive më të përparuara shkencore e teknologjike dhe u jep vlerë ekspertizës dhe aftësive kërkimore të tij në fusha të ndryshme të shkencës dhe kërkimit.

Kërkimi shkencor në Universitetin Politeknik të Tiranës është veprimtari me interes të gjerë publik, që ndërmerret për të përmbushur misionin e njësive bazë të tij, sipas standardeve bashkëkohore europiane. Veprimtaritë kryesore kërkimore dhe të zhvillimit në Universitetin Politeknik të Tiranës lidhen me:

- punën krijuese të ndërmarrë mbi një bazë sistematike pranë njësive bazë të UPT, në mënyrë që të rritet bagazhi i dijeve;
- pjesëmarrjen në programe kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, konferenca, seminare, kongrese, workshop-e, etj;
- publikimin e monografive dhe artikujve në periodikë apo seri botimesh shkencore me bord vlerësues dhe drejtues;
- pjesëmarrjen në borde revishtash shkencore; udhëheqjen e doktoratave, etj.

Për më shumë informacion
skanoni kodin ose vizitoni:
<https://upt.edu.al/kerkimi-shkencor/>



2.5.2. Programet e studimit të ciklit 3 - Doktorata

Universiteti Politeknik i Tiranës ofron programe studimi të ciklit të tretë "Doktoratë" në bazë të projekteve kërkimore-shkencore dhe të zhvillimit të njësive bazë dhe kryesore. Këto programe realizohen në koordinim me veprimtari të kërkimit të grupeve kërkimore brenda njësive bazë, njësive kryesore dhe Universitetit Politeknik të Tiranës.

Numri i studentëve doktorantë përcaktohet nga njësia bazë dhe projekti kërkimor i çdo doktoranti përcaktohet në varësi të projekteve kërkimore të kësaj të fundit. Drejtuesit shkencorë të doktorantëve në Universitetin Politeknik të Tiranës mbajnë të gjithë titullin "Profesor" ose "Profesor i asociuar".

Programet e ciklit të tretë "Doktoratë" në Universitetin Politeknik të Tiranës i përkasin nivelit 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe zhvillohen me kohë të plotë apo me kohë të zgjatur pranë njësive bazë/kryesore. Kohëzgjatja normale e këtyre programeve studimi është 3-5 vite akademike dhe në përfundim të tyre lëshohet diploma e gradës shkencore "Doktor" në fushën përkatëse të studimit.

Universiteti Politeknik i Tiranës ka ngritur Komisionin e përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor" pranë çdo njësie kryesore të tij. Komisioni i përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor" në UPT mban emërtimin "Këshilli i Profesorëve" dhe anëtarët e tij janë personel akademik me kohë të plotë të kategorisë "Profesor". Këshilli i Profesorëve pas mbrojtjes së doktoratës dhe vlerësimit të jurisë merr vendimin për dhënien ose jo të gradës shkencore "Doktor", etj.

2.6 NDËRKOMBËTARIZIMI

Universiteti Politeknik i Tiranës e vlerëson si të rëndësishëm pjesëmarrjen në programe ndërkombëtare dhe është gjithmonë në kërkim të mundësive që stafi dhe studentët të ndihen pjesë e komunitetit evropian të kërkuesve, të jenë pjesë e aktiviteteve kërkimore dhe të marrin një përvojë të vlefshme që të mund ta ndajnë me komunitetin e tyre dhe ta zbatojnë në tregun e punës.

2.6.1. Fonde të Bashkimit Europian në UPT

Fondet e BE-së përfitojnë nëpërmjet programeve të veçanta si Horizon dhe Erasmus+

HORIZON EUROPE është programi kryesor i financimit të BE-së për kërkimin dhe inovacionin. Programi ka në fokus ndryshimet klimatike, ndihmon në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së dhe nxit konkurrencën dhe rritjen e BE-së.

Programi lehtëson bashkëpunimin dhe forcon ndikimin e kërkimit dhe inovacionit në zhvillimin, mbështetjen dhe zbatimin e politikave të BE-së, dhe trajton sfidat globale, nëpërmjet financimit për krijimin dhe shpërndarjen më të mirë të njohurive dhe teknologjisë.

Horizon Europe është organizuar në tre shtylla kryesore:

I. Excellent Science (Përsosmëria në Shkencë)

II. Global Challenges & European Industrial Competitiveness (Sfidat Globale & Konkurrueshmëria Industriale Evropiane)

III. Innovative Europe (Evropa Inovative)

Në kuadër të këtij programi Universiteti Politeknik i Tiranës është pjesë e një projekti (AHEAD) që i përket shtyllës së dytë, në grupin: Klima, Energjia dhe Mobiliteti.

ERASMUS 2021-2027 është skema e Veprimit të Rajonit Evropian për Lëvizshmërinë e Studentëve të Universitetit dhe është një program i financuar nga BE që lejon studentët nga vendet brenda dhe jashtë BE-së të marrin pjesë në shkëmbime jashtë vendit të tyre universitar.

Ky program i mundëson universitetit dhe studentëve fonde për rritjen e kapaciteteve dhe shkëmbimeve (KA1) bazuar në një marrëveshje kontraktuale midis institucioneve.

2.6.2. Projekte në kuadër të rritjes së kapaciteteve

Universiteti Politeknik i Tiranës është përfshirë në një sërë projektesh të cilat janë pjesë e fushave inxhinierike të saj.



Për më shumë informacion
skanoni kodin ose vizitoni:
<https://upt.edu.al/projekte-ne-upt/>





Universiteti Politeknik i Tiranës ka nënshkruar rreth **100 marrëveshje ndër-institucionale** dhe marrëveshje të përgjithshme me universitete në mbarë botën.

2.6.3. Mobilitetet studentore Erasmus (KA1)

Në kuadër të programit Erasmus+ promovohen mobilitetet e studentëve dhe stafit akademik në universitetet homologe në Europë e më tej, bazuar në marrëveshjet ndër-institucionale. Në mobilitetet janë përfshirë një numër i konsiderueshëm studentësh, të cilët kanë patur përvoja shumë pozitive dhe të frytshme, me ndikim të rëndësishëm në formimin e tyre.

Bashkëpunimi në partneritet të plotë me institucione homologe në nivel akademik dhe shkencor ka qënë një nga prioritetet kyçe të Universitetit Politeknik të Tiranës.

Së fundmi Universitetit Politeknik të Tiranës i është akorduar nga Komisioni Evropian **Certifikata Evropiane për Institucionet e Arsimit të Lartë (ECHE)** për periudhën 2021-2027.



Mobilitetet në periudhën 2021-2025 në Universitetin Politeknik të Tiranës

252

MOBILITETE
DALËSE -
STUDENTË

108

MOBILITETE
HYRËSE -
STUDENTË

360

MOBILITETE
STUDENTORE
TOTAL

216

MOBILITETE
HYRËSE -
STAFI

293

MOBILITETE
DALËSE -
STAFI

869

MOBILITETE
TOTALE

SI MUND TË APLIKOSH PËR SHKËMBIMET ERASMUS + (KA1)

1. Shiko thirrjet e hapura për shkëmbimet Erasmus+

Në Universitetin Politeknik të Tiranës, thirrjet për programin Erasmus+ publikohen në faqen zyrtare të UPT-së: **upt.edu.al**, në **mediat sociale zyrtare** të tij (Facebook dhe Instagram), si edhe në **faqet zyrtare të internetit të Fakulteteve**, pjesë e Universitetit Politeknik.

Në thirrjet e hapura do të gjeni informacion specifik për secilin universitet, por studentët janë të mirëpritur në çdo kohë lidhur me aplikimin në zyrën Erasmus e cila ndodhet në katin e parë (godina e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike).

2. Kur dhe ku mund të aplikoj?

Për t'u bërë pjesë e këtij programi, **aplikoni pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në Rektoratin e UPT-së**:

Për semestrin e parë, aplikimi bëhet në periudhën **Mars - Maj të vitit akademik paraardhës**.

Për semestrin e dytë, aplikimi bëhet në periudhën **Shtator - Nëntor të vitit akademik paraardhës**.

Dokumentet standarde për aplikim janë:

- CV
- Kopje e Pasaportës
- Vërtetim studenti
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze)
- Listë notash e studimeve, deri në momentin e aplikimit
- Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht, niveli B2)
- Dokumenti Learning Agreement (Marrëveshja e studimeve që nënshkruhet nga studenti, Universiteti Politeknik dhe universiteti pritës)



MARRËVESHJET ERASMUS + (KA1) UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

AUSTRI
UNIVERSITÄT FÜR BODENKULTUR WIEN

BELGIKË
HOOGENT UNIVERSITY

BULLGARI
TECHNICAL UNIVERSITY SOFIA

DANIMARKË
AARHUS UNIVERSITY

ESTONI
UNIVERSITY OF APPLIED SCIENCES TTK

FRANCË
UNIVERSITE DE TECHNOLOGIE DE
COMPIEGNE (UTC)
UNIVERSITY OF POITIERS
IMT MINES ALES
ÉCOLE SPÉCIALE DES TRAVAUX PUBLICS,
DU BÂTIMENT ET DE L'INDUSTRIE (ESTP)
ÉCOLE NATIONALE DU GÉNIE DE L'EAU ET
DE L'ENVIRONNEMENT DE STRASBOURG
POLYTECHNICAL INSTITUTE OF BORDEAUX-
ENSEGID
UNIVERSITE DE LIMOGES
ORLEANS UNIVERSITY
DE VINCI ESILV ENGINEERING SCHOOL
ÉCOLE CENTRALE DE LYON - PUT

GJERMANI
ANHALT UNIVERSITY OF APPLIED SCIENCES
KÖLN UNIVERSITY
WESTSÄCHSISCHE HOCHSCHULE ZWICKAU
BRANDENBURG UNIVERSITY OF
TECHNOLOGY COTTBUS SENFETENBERG
TECHNISCHE HOCHSCHULE LUBECK
UNIVERSITÄT KASSEL
FB BIELEFELD UNIVERSITY

GREQI
UNIVERSITY OF WEST ATTICA
UNIVERSITY OF WESTERN MACEDONIA
UNIVERSITY OF CRETE

HOLANDË
VAN HALL LARENSTEIN UNIVERSITY
SAXION, UNIVERSITY OF APPLIED SCIENCES

HUNGARI
EÖTVÖS LORÁND UNIVERSITY

ITALI
TUSCIA UNIVERSITY
POLITECNICO DI TORINO
UNIVERSITY OF TRENTO
POLITECNICO DI BARI
POLITECNICO DI MILANO
UNIVERSITÀ IUAV VENEZIA
UNIVERSITY OF CHIETI "G. D'ANNUNZIO"
UNIVERSITY DEGLI STUDI DI GENOVA
UNIVERSITÀ DI SIENA
URBINO UNIVERSITY
PERUGIA UNIVERSITY
SALENTO UNIVERSITY
UNIVERSITY OF CALABRIA
UNIVERSITÀ DEGLI STUDI DELLA BASILICATA

KROACI
UNIVERSITY OF ZAGREB

LETONI
RIGA TECHNICAL UNIVERSITY

LITUANI
VILNIAUS KOLEGIJA/UNIVERSITY OF
APPLIED SCIENCES

NORVEGJI
NORWEGIAN UNIVERSITY OF SCIENCE
AND TECH

POLONI
AGH UST UNIVERSITY
UNIVERSITY OF APPLIED SCIENCES NYSA

PORTUGALI
ISCTE LISBOA
POLYTECHNIC UNIVERSITY OF VISEU
POLYTECHNIC OF PORTO SCHOOL OF
MANAG & TECH
INSTITUTO POLITECNICO DO PORTO

REPUBLIKA ÇEKE
TECHNICAL UNIVERSITY OF LIBEREC

RNM
OHRID UIST UNIVERSITY

RUMANI
UNIVERSITY OF ORADEA
TRANSILVANIA UNIVERSITY, BRASOV
UNIVERSITY OF CLUJ-NAPOCA
TARGU MURES UNIVERSITY
IASI UNIVERSITY
GHEORGHE ASACHI UNIVERSITY

SERBI
ACADEMY OF PROFESIONAL STUDIES
SOUTH SERBIA

SLLOVAKI
SLOVAK UNIVERSITY OF TECHNOLOGY IN
BRATISLAV

SLLOVENI
UNIVERSITY OF LJUBLJANA

SPANJË
UNIVERSITY OF SALAMANCA
UNIVERSITY OF A CORUNA
UNIVERSITY OF CATALUNYA,
BARCELONA
UNIVERSITY OF SEVILLE
UNIVERSITY OF OVIEDO

SUEDI
MÄLARDALEN UNIVERSITY

TURQI
ISTANBUL TECHNICAL UNIVERSITY
SAKARYA UNIVERSITY
ONDOKUZ MAYIS UNIVERSITY
AFYON KOCATEPE UNIVERSITY
TARSUS UNIVERSITY
DOKUZ EYLUL UNIVERSITY
FIRAT UNIVERSITY
EGE UNIVERSITY

UK
UNIVERSITY OF WESTMINSTER





2.6.4. Diplomat e dyfishta

Universiteti Politeknik i Tiranës ofron Diploma të Dyfishta në bashkëpunim me universitetet e mëposhtme:

- 1. **ESTP - ÉCOLE SPÉCIALE DES TRAVAUX PUBLICS, DU BÂTIMENT ET DE L'INDUSTRIE / FRANCË**
Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit
- 2. **UNIVERSITE DE COMPIEGNE / FRANCË**
Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit
- 3. **UNIVERSITÀ IUAV DI VENEZIA / ITALI**
Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës
- 4. **UNIVERSITÀ DI FIRENZE / ITALI**
Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave
- 5. **UNIVERSITÀ DI TUSCIA / ITALI**
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
- 6. **UNIVERSITÀ DEGLI STUDI DI GENOVA / ITALI**
Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit
- 7. **POLITECNICO DI BARI / ITALI**
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
- 8. **UNIVERSITÀ DI SALENTO / ITALI**
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
- 9. **UNIVERSITÀ DI FIRENZE / ITALI**
Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës

2.7 NJËSITË PËRBËRËSE TË UNIVERSITETIT POLITEKNIK

Universiteti Politeknik i Tiranës është Institucion Publik cilësor i arsimit të lartë dhe lider në fushat e tij të ekspertizës. Ai synon përsosjen dhe konsolidimin e formimit akademik dhe zgjidhjen e problemeve të rëndësishme kërkimore dhe shkencore, në shkallë vendi dhe rajoni.

Universiteti Politeknik i Tiranës, synon të përgatisë specialistë me njohuri dhe aftësi inxhinierike të nevojshme për t'u bërë ballë sfidave me të cilat i përball koha.

Duke patur studentin në qendër të vëmendjes, Universiteti Politeknik i Tiranës synon zhvillim të qendrueshëm të kapaciteteve infrastrukturore, duke përmirësuar standardin m²/student, duke

ofruar një bazë laboratorike të kompletuar, duke vënë në përdorim për qëllime studimi dhe organizimi të punës në institucion teknologjitë moderne të informacionit dhe duke krijuar një mjedis tërheqës.

Për të bërë të mundur lidhjen e programeve të studimit me tregun e punës, Universiteti Politeknik i Tiranës bën një monitorim të vazhdueshëm të tij dhe krijon ura bashkëpunimi, me qëllim krijimin e mundësive për praktika dhe më pas punësimin e studentëve.

Universiteti Politeknik i Tiranës specializohet në fushat e Inxhinierisë dhe Arkitekturës. Ai përbëhet nga **7 Fakultete** dhe **1 Institut kërkimor**.

Programi	Vitet	Kreditet
Bachelor	3	180
Master Profesional	1-2	60/120
Master i Shkencave	2	120
Diplomë e integruar	5	300
Doktoratë	3+	



PROGRAME TË REJA

Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit (FTI), Universiteti Politeknik i Tiranës, në bashkëpunim me Universitetin Teknologjik të Compiègne (UTC) në Francë, shpall hapjen e dy programeve të përbashkëta Bachelor me diplomë të dyfishtë:

- Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike
- Bachelor në Inxhinieri e Sistemeve Elektronike

Planet mësimore janë të përbashkëta FTI/ UPT – UTC, të ndërtuara sipas standardeve më të larta evropiane dhe në përputhje me nevojat e tregut të punës. Mësimi do të zhvillohet në gjuhët, shqip, frëngjisht dhe anglisht.

Në përfundim të studimeve, studentët pajisen me dy diploma përkatësisht nga Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) dhe Universiteti Teknologjik Compiègne (UTC).

FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS

Departamenti i Arkitekturës

Departamenti i Urbanistikës

Departamenti i Restaurimit dhe Teknologjisë së Arkitekturës

Qendra Kërkimore Shkencore

Pak histori

Studimet për arkitekturë për herë të parë filluan në vitin 1969 dhe në 1983 dega e Arkitekturës u bë pjesë e fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit në kuadër të Universitetit të Tiranës. Në 1993 u krijua Departamenti i Arkitekturës dhe Urbanistikës i cili funksionoi deri në 2013.

Në Janar të vitit 2013, u krijua Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, i cili mbart mbi vete traditën dhe përvojën dhjetra-vjeçare të Universitetit Politeknik të Tiranës në fushën e arkitekturës dhe urbanistikës.

Dekan

Prof. Asoc. Armand Vokshi
armand.vokshi@fau.edu.al

Zv. Dekan

Dr. Loreta Çapeli
loreta.capeli@fau.edu.al

Zv. Dekan

MSc. Ani Panariti Tola
ani.tola@fau.edu.al

PROGRAMET E STUDIMIT

BACHELOR

Arkitekturë Interieri dhe Dizajn

MASTER PROFESIONAL

Restaurim i Monumenteve të Kulturës

PROGRAME TË INTEGRUARA STUDIMI TË CIKLIT I & II

Arkitekturë - profili Arkitekt

Urbanistikë - profili Urbanist

■ **Diplomë e dyfishtë**
në bashkëpunim me
Universitetin IUAV në
Venecia, Itali.

■ **Diplomë e dyfishtë**
në bashkëpunim me
Universitetin e Firenzës, Itali.



FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS / FAU

Adresa: Rr. "Muhamet Gjollësja", 54, Tiranë,
pranë kryqëzimit të "21 Dhjetorit"

*Këtë vit akademik studentët e Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës do të zhvillojnë mësim në godinat e Korpusit Qendror të Universitetit Politeknik të Tiranës (Sheshi Nënë Tereza) për shkak të rikonstruktimit të godinës së fakultetit.



Për më shumë
informacion
skanoni kodin
ose vizitoni

www.fau.edu.al

FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT

Departamenti i Konstruksioneve të Ndërtimit dhe Infrastrukturës së Transportit

Departamenti i Mekanikës së Strukturave

Departamenti i Inxhinierisë së Mjedisit

Departamenti i Hidraulikës dhe Hidroteknikës

Departamenti i Gjeodezisë

Pak histori

Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit është një nga fakultetet më të vjetra dhe më me përvojë në arsimin e lartë shqiptar. Ai është themeluar më 1951 si Dega Ndërtim në kuadër të Institutit të Lartë Politeknik të Tiranës, dhe në vitin 1983 Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit u krijua si njësi më vete.

Që prej krijimit të Institutit Politeknik e deri më sot, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit si njësi kryesore e Universitetit Politeknik të Tiranës i ka dhënë vendit një histori suksesi. Veprat më të mëdha e të rëndësishme në fushën e ndërtimit e arkitekturës mbajnë vulën e mendimit të përparuar të inxhinierëve e arkitektëve të formuar në auditorët e Fakultetit e Inxhinierisë së Ndërtimit.

Dekan


Prof. Asoc. Neritan Shkodrani
neritan.shkodrani@fin.edu.al

Zv. Dekan

Prof. Asoc. Konalsi Gjoka
konalsi.gjoka@fin.edu.al

Zv. Dekan

Dr. Alketa Ndoj
alketa.ndoj@fin.edu.al



PROGRAMET E STUDIMIT

BACHELOR

Inxhinieri Ndërtimi

Inxhinieri Mjedisit

Gjeodezi

Hidroteknikë

MASTER PROFESIONAL

Inxhinieri Gjeodezi

Inxhinieri Mjedisit

Inxhinieri Hidroteknikë

MASTER I SHKENCAVE

Inxhinieri Ndërtimi

- Profili Strukturist
- Profili Gjeoteknikë
- Profili Infrastrukturë e Transportit

Inxhinieri Mjedisit

- Profili Trajtim Uji
- Profili Energjetikë

Inxhinieri Hidroteknike

Inxhinieri Gjeodezi

DOKTORATË

Gjeodezi

Inxhinieri mjedisit

Inxhinieri ndërtimi

Diplomë e dyfishtë

në Inxhinieri Ndërtimi
në partneritet me Ecole
Speciale des Travaux
Publics, Paris - Francë.

FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT / FIN

Adresa: Rr. "Muhamet Gjollësja", 54, Tiranë,
pranë kryqëzimit të "21 Dhjetorit"



Për më shumë
informacion
skanoni kodin
ose vizitoni
www.fin.edu.al

FAKULTETI I INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE

Departamenti i Inxhinierisë Matematike

Departamenti i Inxhinierisë Fizike

Departamenti i Inxhinierisë Kimike

Qendra e Gjuhëve të Huaja

Pak histori

Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike u krijua si pjesë përbërëse e Universitetit Politeknik të Tiranës në vitin 2007. Ky është një fakultet i cili ofron formim bazë dhe të avancuar të shkencave inxhinierike si dhe të shkencave kompjuterike, fotonike, elektronike, optike, automatizim dhe telekomunikacion. Studentët të cilët diplomohen pranë FIMIF punësohen në shumë fusha të ekonomisë ndër të cilat mund të përmendim: inxhinierët në laboratorët e kontrollit dhe të testimit të materialeve; inxhinierët për aplikimin e metodave moderne të matjes së rrezatimeve optike, të temperaturës, emisioneve akustike, përdorimit të ultratingujve për qëllime industriale dhe mjekësore; inxhinierët për përdorimin e pajisjeve lazer dhe me fibra optike në teknologjinë e komunikimit etj.

Dekan

Prof. Asoc. Teuta Myftiu
t.myftiu@fimif.edu.al

Zv. Dekan

Prof. Asoc. Endri Raço
e.raco@fimif.edu.al

Zv. Dekan

Prof. Asoc. Dhurata Kuqi
dh.kuqi@fimif.edu.al



PROGRAMET E STUDIMIT

BACHELOR

Inxhinieri Matematike

Inxhinieri Fizike

Inxhinieri Kimike

MASTER PROFESIONAL

Inxhinieri Matematike -
Analizë sistemes

MASTER I SHKENCAVE

Inxhinieri Matematike

Inxhinieri Matematike -
Aktuaristikë

Inxhinieri Fizike

- Fizikan mjekësor
- Inxhinier Fizike

DOKTORATË

Inxhinieri matematike dhe Fizike

- Inxhinieri Fizike
- Inxhinieri Matematike

FAKULTETI I INXHINIERISË FIZIKE DHE INXHINIERISË KIMIKE / FIMIF

Adresa: Rr. "Muhamet Gjollësia", mbrapa shkollës
"Vasil Shanto", Tiranë



Për më shumë
informacion
skanoni kodin
ose vizitoni

www.fimif.edu.al

FAKULTETI I GJEOLGJISË DHE MINIERAVE

Departamenti i Shkencave të Tokës

Departamenti i Gjeologjisë të Zbatuar dhe Gjeoinformatikës

Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve Minerare

Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve të Energjisë

Pak histori

Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minerave është shkolla e parë e lartë në Shqipëri për përgatitjen e specialistëve për të gjitha degët e shkencave të industrisë minerare.

Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minerave u formua dhe u zhvillua në kuadrin e Institutit të Lartë Politeknik të Tiranës dhe Fakultetit të Inxhinierisë të Universitetit të Tiranës. Mbi këtë bazë, drejtimi i përgatitjes së studentëve ka qënë dhënia e titullit "Inxhinier" për të gjitha specialitetet që përgatiteshin.

Dekan



Prof. Asoc. Shkëlqim Daja
shkelqim.daja@fgjm.edu.al

Zv. Dekan

Dr. Altin Karriqi
altin.karriqi@fgjm.edu.al

Zv. Dekan

Dr. Arjol Lule
arjol.lule@fgjm.edu.al



PROGRAMET E STUDIMIT

BACHELOR

Inxhinieri Gjeologjike

Inxhinieri Gjeoinformatike

Inxhinieri e Burimeve Minerare

Inxhinieri e Naftës dhe Gazit

Inxhinieri Gjeomjedisi

MASTER PROFESIONAL

Inxhinieri e Burimeve Minerare

- Inxhinieri Miniere
- Gjeomatikë
- Pasurimi i Mineraleve dhe Riciklimi i Mbetjeve

Inxhinieri Gjeologjike

- Gjeoinformatikë
- Vendburimet e Mineraleve të Dobishme-Petrologji
- Gjeologji Inxhinierike dhe Hidrogjeologji
- Gjeologji e Vendburimeve të Hidrokarbureve

Inxhinieri e Naftës dhe Gazit

Inxhinieri Gjeomjedisi

MASTER I SHKENCAVE

Inxhinieri e Burimeve Minerare

- Inxhinieri Minerare dhe Markshajderi
- Pasurimi i Mineraleve dhe Riciklimi i Mbetjeve

Inxhinieri e Naftës dhe Gazit

Inxhinieri Gjeologjike

- Gjeoinformatikë
- Gjeologji Inxhinierike dhe Hidrogjeologji
- Vendburimet e Mineraleve të Dobishme-Petrologji
- Gjeologji e Vendburimeve të Hidrokarbureve

Inxhinieri Gjeomjedisi

Diplomë e dyfishtë në
Inxhinieri Gjeomjedisi në
partneritet me Universitetin
e Firences, Itall.

DOKTORATË

Gjeologjia dhe Mjedisi

- Inxhinieri Naftë dhe Gazi
- Gjeologjia dhe Mjedisi

FAKULTETI I GJEOLGJISË DHE MINIERAVE / FGJM
Adresa: Rr.Elbasanit, Tiranë, pranë kodrave të Liqenit Artificial



Për më shumë
informacion
skanoni kodin
ose vizitoni

www.fgjm.edu.al

FAKULTETI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit

Departamenti i Inxhinierisë Informatike

Departamenti i Bazave të Informatikës

Pak histori

Historia e Degës së Inxhinierisë Elektronike fillon që prej viteve '60, me formimin e Katedrës së Elektronikës, si pjesë e Fakultetit të Inxhinierisë. Krijimi i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit daton në 2007. Programet e studimit të FTL-së ofrojnë njohuri në fushat e arkitekturës e sistemeve të telekomunikacioneve, teknikave numerike dhe analoge të përpunimit dhe transmetimit të sinjaleve multimediale, sistemet satelitore, sistemet me fibra optike, protokollet e transmetimit të të dhënave, rrjetat e kompjuterave, rrjetat me sensorë, rrjetat ad-hoc, arkitekturën e sistemeve të përpunimit, strukturën e bazave të të dhënave, sistemet e shpërndarë, inxhinieria e softuerit, teknologjitë web, elementët bazë të sistemeve elektronike, projektimin e elementëve përbërës të sistemeve elektronike, aplikimet e sistemeve elektronike në industri, etj.

Dekan

Prof. Dr. Elinda Meçe
ekajo@fti.edu.al

Zv. Dekan

Prof. Dr. Indrit Enesi
ienesi@fti.edu.al

Zv. Dekan

Dr. Nelda Kote
nkote@fti.edu.al



PROGRAMET E STUDIMIT

BACHELOR

Inxhinieri Elektronike

Inxhinieri Informatike

Inxhinieri të
Telekomunikacioneve

■ Inxhinieri të Sistemeve Elektronike
(Diplomë e dyfishtë UPT/UTC)

■ Inxhinieri Kompjuterike
(Diplomë e dyfishtë UPT/UTC)

MASTER PROFESIONAL

Inxhinieri Software

Teknologji Informacioni

MASTER I SHKENCAVE

Inxhinieri Elektronike

Inxhinieri Informatike

Inxhinieri Telekomunikacioni

■ Inteligjencë Artificiale dhe
Optimizim

■ **Master i delokalizuar** në 'Inteligjencë Artificiale dhe Optimizim' në partneritet me University of Technology of Compiegne (UTC), Francë.

■ **Diplomë e dyfishtë** në Inxhinieri Informatike dhe Inxhinieri Elektronike në bashkëpunim me Università degli Studi di Genova, Itali.

FAKULTETI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT / FTI

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",
Sheshi "Nënë Tereza", godina e re pas Korpusit Qendror.

DOKTORATË

Teknologjitë e Informacionit
dhe Komunikimit

- Inxhinieri Informatike
- Telekomunikacion dhe
Inxhinieri Informacioni



Për më shumë
informacion
skanoni kodin
ose vizitoni

www.fti.edu.al

FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

Departamenti i Energjitikës

Departamenti i Mekanikës

Departamenti i Prodhim Menaxhimit

Departamenti i Tekstil dhe Modës

Pak histori

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike është e para shkollë e lartë në Shqipëri për përgatitjen e specialistëve të lartë në fushat e mekanikës, metalurgjisë dhe materialeve dhe tekstil modës i cili daton që nga viti 1951.

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike formësohet si njësi e pavarur e Universitetit Politeknik në vitin 1991.

Dekan

Prof. Genti Guxho
gguxho@fim.edu.al

Zv. Dekan

Prof. Dr. Altin Dorri
adorri@fim.edu.al

Zv. Dekan

Prof. Asoc. Ilda Kazani
ikazani@fim.edu.al



PROGRAMET E STUDIMIT

BACHELOR

Inxhinieri Mekanike

Inxhinieri Tekstile e Mode

Inxhinieri Materiale

Inxhinieri Ekonomike

Inxhinieri Matematike
dhe Data Science

MASTER PROFESIONAL

Inxhinieri Transporti

Inxhinieri Materiale

MASTER I SHKENCAVE

Inxhinieri Mekanike

- Konstruksion Makinash dhe Mjete Lëvizëse
- Energjetikë
- Prodhim dhe Menaxhim Industrial

Inxhinieri Materiale - Materiale

Inxhinieri Tekstili dhe Mode

Inxhinieri Ekonomike

Menaxhim Energjie

DOKTORATË

Inxhinieri Mekanike

- Konstruksione mekanike dhe vlerësimi i integritetit të strukturave

■ **Diplomë e dyfishtë** në Inxhinieri Mekanike - profili Energjitikë në bashkëpunim me University of Tuscia, Viterbo, Itali.

■ **Diplomë e dyfishtë** në Inxhinieri Mekanike në bashkëpunim me Politecnico di Bari, Itali.

■ **Diplomë e dyfishtë** në bashkëpunim me Universitetin e Salentos, Itali.

FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE / FIM

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",
Sheshi "Nënë Tereza", godina e Korpusit Qendror.



Për më shumë
informacion
skanoni kodin
ose vizitoni
www.fim.edu.al

FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE

Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë

Departamenti i Elektroteknikës

Departamenti i Automatizimit

Pak histori

Në vitin 1951 themelohet Instituti Politeknik në Tiranë në të cilin bënte pjesë edhe Fakulteti Elektroteknik. Dy vite më vonë, në 1953, filloi sistemi pa shpëputje nga puna për përgatitjen e inxhinierëve elektrikë. Fakulteti i Inxhinierisë ndahet në dy fakultete në vitin 1983: në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Elektrike (FIME) dhe në atë të Inxhinierisë së Ndërtimit (FIN).

Në vitin 2008, me propozim të MASH dhe VKM ish-Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike (FIE) (1991-2007) ndahet në dy fakultete: Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit.

Dekan


Prof. Asoc. Astrit Bardhi
astrit.bardhi@upt.al

Zv. Dekan

Dr. Alfred Pjetri
alfred.pjetri@fie.upt.al

Zv. Dekan

Prof. Dr. Myrteza Braneshi
mbraneshi@upt.al



PROGRAMET E STUDIMIT

BACHELOR

Inxhinieri Elektrike -
Energjetikë

Inxhinieri Elektrike -
Automatizim i Industrisë

Inxhinieri Mekanike

MASTER PROFESIONAL

Inxhinieri Elektrike -
Automatizim i industrisë

Elektroenergjetikë

Inxhinieri Mekanike

MASTER I SHKENCAVE

Inxhinieri Elektrike

- Energjetikë
- Automatizimi i Industrisë

Inxhinieri Mekanike

DOKTORATË

Inxhinieri Elektrike

- Automatizim i Industrisë
- Energjetikë

FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE / FIE

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",
Sheshi "Nënë Tereza", godina e Korpusit Qendror.



Për më shumë
informacion
skanoni kodin
ose vizitoni
www.fie.upt.al

INSTITUTI I GJEOSHKENCAVE

Klima dhe mjedisi
Ekonomia ujore
Sizmologji
Gjeologji

IGJEO, ish Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM), përfaqëson një nga njësitë kryesore të Universitetit Politeknik të Tiranës. IGJEO ka në zotërim dhe operon rrjetin kombëtar Sizmik, Hidrologjik dhe Meteorologjik.

Shërbimet kryesore të IGJEO-s janë:

- Studimi i fenomeneve gjeologjike si: fenomenet gjeofizike, gjeomekanike etj. si dhe krijimi mbi bazën e tyre i hartave gjeologjike dhe tematike;
- Studimi dhe vlerësimi i burimeve natyrore të vendit përsa i përket burimeve nëntokësore minerale, energjetike dhe atyre ujore.
- Realizimi i kërkimit shkencor në fushën e rreziqeve natyrore si dhe të atyre të krijuara nga aktiviteti i njeriut (rrëshqitje, erozion, përmbytje, ndotje e mjedisit, etj.);
- Studim i mikrozonimit në lidhje me vlerësimin e riskut sizmik në shkallë lokale dhe kombëtare;
- Adoptimi i standardeve evropiane në studimet sizmike.
- Studimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i aktivitetit sizmik të vendit dhe mundësimi i shpërndarjes së të dhënave në kohë reale për vendimmarrësit dhe opinionin e gjerë.

Drejtor IGJEO

Prof. Asoc. Ylber Muçeku
y.muçeku@geo.edu.al



INSTITUTI I GJEOSHKENCAVE / IGJEO

Adresa: Rruga Don Bosko, Tiranë



Për më shumë
informacion
skanoni kodin
ose vizitoni

www.geo.edu.al

KËSHILLA NGA STUDENTËT PËR STUDENTËT

SI TË MENAXHOJMË KOHËN E STUDIMIT GJATË SEZONIT TË PROVIMEVE?

Përgatit një kalendar pune/studimi!

Mbaj parasysh datat e provimeve dhe sa nevojë ke për të mësuar apo përsëritur çdo lëndë. Ndaje materialin në detyra javore ose ditore sipas ditëve që ke në dispozicion.

Vendos prioritetet!

Nise gjithmonë me detyrat më të rëndësishme.

Pusho dhe relakso trurin!

Mund të jetë një pushim 10 minuta pas 1 ore studim. Pini ujë, hani një frut, dëgjoni 2-3 këngë.

Kupto nëse përthith më shumë informacion në mëngjes apo mbasdite/në darkë!

Nëse truri juaj përthith më shumë në mëngjes, sigurohuni që gjatë kësaj periudhe të ditës të mësoni tema që i konsideroni të vështira, dhe gjatë pasdites mund të përsërisni ose studioni një material të thjeshtë.

Ji fleksibël!

Jo gjithmonë planet shkojnë siç ne dëshirojmë. Kur bëni kalendarin e punës lini 1-2 ditë për përsëritje të përgjithshme në mënyrë që të keni gjithmonë diçka rezervë.

03

TARIFAT E STUDIMIT

3.1 TARIFAT NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

Në ndihmë të studentëve, në këtë kapitull do të paraqitet një përmbledhje e tarifave të studimit në Fakultetet e Universitetit Politeknik të Tiranës për vitin akademik 2025 - 2026.

Tarifat në vijim janë të vlefshme vetëm për vitin akademik 2025 - 2026, pasi ato janë të ndryshueshme në bazë të vendimeve që merren nga institucionet përkatëse.

a. Tarifat e regjistrimit për programet në Universitetin Politeknik të Tiranës për vitin akademik 2025-2026

Nr.	Programi i studimit	Tarifa /lekë
1	Tarifa e regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve	1600
2	Tarifa e regjistrimit në programet e ciklit të dytë të studimeve	2500
3	Tarifa e regjistrimit për programet e dyta të studimit	3000
4	Tarifa e regjistrimit për transferimin e studimeve	3000
5	Tarifa e regjistrimit për programet e ciklit të tretë	3000
6	Tarifa e regjistrimit për kandidatët nga trojet shqiptare	2000

b. Tarifat e Shkollimit në programet e studimeve të ciklit të parë Bachelor për vitin akademik 2025-2026

Nr.	Fakulteti	Programi i Studimit	Tarifa programi i parë 60 Kredite / 1 vit	Tarifa programi i dytë 60 Kredite / 1 vit
1	Fakulteti Arkitekturës dhe Urbanistikës	Bachelor në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn	40,000	203,690
2	Fakulteti Inxhinierisë Elektrike	Bachelor në Inxhinieri Elektrike, profili Energjitikë	25,000	203,690
		Bachelor në Inxhinieri Elektrike, profili Automatizim Industrie	25,000	203,690
		Bachelor në Inxhinieri Mekatronikë	25,000	203,690

3	Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minerave	Bachelor në Inxhinieri Gjeomjedisi	25,000	203,690
		Bachelor në Inxhinieri Gjeoinformatikë	25,000	203,690
		Bachelor në Inxhinieri e Burimeve Minerare	25,000	203,690
		Bachelor në Inxhinieri e Naftës dhe e Gazit	25,000	203,690
		Bachelor në Inxhinieri Gjeologjike	25,000	203,690
4	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	Bachelor në Inxhinieri Mekanike	25,000	203,690
		Bachelor në Inxhinieri Tekstile dhe Modë	25,000	203,690
		Bachelor në Inxhinieri Materiale	25,000	203,690
		Bachelor në Inxhinieri Ekonomike	25,000	203,690
		Bachelor në Inxhinieri Matematike dhe Data Science	25,000	203,690
5	Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike	Bachelor në Inxhinieri Matematike	25,000	203,690
		Bachelor në Inxhinieri Kimike	25,000	203,690
		Bachelor në Inxhinieri Fizike	25,000	203,690
6	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi	35,000	203,690
		Bachelor në Inxhinieri Mjedisi	25,000	203,690
		Bachelor në Gjeodezi	25,000	203,690
		Bachelor në Hidroteknikë	25,000	203,690
7	Fakulteti i Teknologjisë Informacionit	Bachelor në Inxhinieri Elektronike	30,000	203,690
		Bachelor në Inxhinieri Informatike	30,000	203,690
		Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacionit	30,000	203,690
		Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike	30,000	203,690
		Bachelor në Inxhinieri të Sistemeve Elektronike	30,000	203,690

c. Tarifat e shkollimit në programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave"
për vitin akademik **2025-2026**

Nr	Fakulteti	Programi i Studimit	Tarifa për Kredit Program i parë	Tarifa për Kredit Program i dytë
1	Fakulteti Inxhinierisë Elektrike	Master i Shkencave në Inxhinieri Elektrike, profili Automatizimi i Industrisë	1500	1,950
		Master i shkencave në Inxhinieri Elektrike, Profili Energjitikë	1500	1,950
		Master i shkencave në Inxhinieri Mekatronike	1500	1,950
2	Fakulteti Gjeologjisë dhe i Minerave	Master i Shkencave në Inxhinieri e Burimeve Minerare, profili Inxhinieri Minerare dhe Markshajderi	1300	1,690
		Master i Shkencave në Inxhinieri e Burimeve Minerare, profili Pasurimi i Mineraleve dhe Riciklimi i Mbetjeve	1300	1,690
		Master i Shkencave në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit	1300	1,690
		Master i Shkencave në Inxhinieri Gjeologjike, profili Gjeoinformatikë	1300	1,690
		Master i Shkencave në Inxhinieri Gjeologjike, profili Gjeologji Inxhinierike dhe Hidrogjeologji	1300	1,690
		Master i Shkencave në Inxhinieri Gjeologjike, profili Vendburimet e Mineraleve të Dobishme -Petrologji	1300	1,690
		Master i Shkencave në Inxhinieri Gjeologjike, profili Gjeologji e Vendburimeve Hidrokarbure	1300	1,690
		Master i shkencave në Inxhinieri Gjeomjedisi	1300	1,690

3	Fakulteti Inxhinierisë Mekanike	Master i Shkencave në Inxhinieri Mekanike, profili Konstruktion Makinash dhe Mjete Lëvizëse	1400	1,560
		Master i Shkencave në Inxhinieri Mekanike, Profili Energjetikë	1400	1,560
		Master i Shkencave në Inxhinieri Mekanike, Profili Prodhim dhe Menaxhim Industrial	1400	1,560
		Master i Shkencave në Inxhinieri Materiale, Profili Materiale	1400	1,560
		Master i Shkencave në Inxhinieri Tekstili dhe Modë	1400	1,560
		Master i Shkencave në Inxhinieri Ekonomike	1400	1,560
		Master i Shkencave në Menaxhim Energjie	1400	1,560
		Master i Shkencave Diplomë e dyfishtë, Inxhinieri Mekanike, profili Energjetikë	1400	1,560
4	Fakulteti Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike	Master i Shkencave në Inxhinieri Matematike	1400	1,820
		Master i Shkencave në Inxhinieri Fizike, profili Fizikan Mjekësor	1400	1,820
		Master i Shkencave në Inxhinieri Fizike, profili Inxhinieri Fizike	1400	1,820
		Master i Shkencave në Inxhinieri Matematike, Profili Aktuaristikë	1400	1820
5	Fakulteti Teknologjisë Informacionit	Master i Shkencave në Inxhinieri Elektronike	1700	2,210
		Master i Shkencave në Inxhinieri Informatike	1700	2,210
		Master i Shkencave në Inteligjencë Artificiale dhe Optimizim	1700	2,210
		Master i Shkencave në Inxhinieri Telekomunikacioni	1700	2,210

6	Fakulteti Inxhinierisë Ndërtimit	Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, profili Strukturist	1750	2,275
		Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, profili Gjeoteknikë	1750	2,275
		Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, profili Infrastrukturë e Transportit	1750	2,275
		Master i Shkencave në Inxhinieri Mjedisi, profili Trajtim Uji	1750	2,275
		Master i Shkencave në Inxhinieri Mjedisi, profili Energjetikë	1750	2,275
		Master i Shkencave në Inxhinieri Hidroteknikë	1750	2,275
		Master i Shkencave në Inxhinieri Gjeodezi	1750	2,275

Nr	Fakulteti	Programi i Studimit	Tarifa për 60 Kredite/ 1 vit	Tarifa për 60 Kredite/ 1 vit
7	Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës	Master i Shkencave në Arkitekturë, profili Arkitekt	40000	203,690
		Master i Shkencave në Arkitekturë, profili Urbanist	40000	203,690

d. Tarifat e shkollimit në programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional ” për vitin akademik 2025-2026

Nr.	Fakulteti	Programi i Studimit	Tarifa për kredit program i parë	Tarifa për kredit program i dytë
1	Fakulteti Arkitekturës dhe Urbanistikës	Master Profesional në Restaurim Monumentesh Kulture	1,100	1,430
2	Fakulteti Inxhinierisë Elektrike	Master Profesional në Inxhinieri Elektrike, profili Automatizim i Industrisë	1,100	1,430
		Master Profesional në Inxhinieri Mekatronike	1,100	1,430
		Master Profesional në Elektroenergjitikë	1,100	1,430
3	Fakulteti Gjeologjisë dhe Minerave	Master profesional në Inxhinieri e Burimeve Minerare, profili Inxhinieri Miniere	1,100	1,430
		Master Profesional në Inxhinieri e Burimeve Minerare, Profili Gjeomatikë	1,100	1,430
		Master Profesional në Inxhinieri e Burimeve Minerare, profili Pasurimi i Mineraleve dhe Riciklimi i Mbetjeve	1,100	1,430
		Master Profesional në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit	1,100	1,430
		Master Profesional në Inxhinieri Gjeologjike, profili Gjeoinformatikë	1,100	1,430
		Master Profesional në Inxhinieri Gjeologjike, profili Gjeologji Inxhinierike dhe Hidrogjeologji	1,100	1,430
		Master Profesional në Inxhinieri Gjeologjike, profili Gjeologji e Vendburimeve Hidrokarbure	1,100	1,430
		Master Profesional në Inxhinieri Gjeologjike, profili Vendburimet e Mineraleve të Dobishme-Petrologji	1,100	1,430
		Master Profesional në Inxhinieri Gjeomjedisi	1,100	1,430

4	Fakulteti Inxhinierisë Mekanike	Master Profesional në Inxhinieri Materiale	1,100	1,430
		Master Profesional në Inxhinieri Transporti	1,100	1,430
5	Fakulteti Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike	Master Profesional në Inxhinieri Matematike në Analizë Sistemes	1,100	1,430
6	Fakulteti Inxhinierisë Ndërtimit	Master Profesinal në Inxhinieri Gjeodezi	1,100	1,430
		Master Profesional në Inxhinieri Mjedisi	1,100	1,430
		Master Profesinal në Inxhinieri Hidroteknikë	1,100	1,430
7	Fakulteti Teknologjisë Informacionit	Master Profesional në Inxhinieri Software	1,100	1,430
		Master Profesional në Teknologji Informacioni	1,100	1,430

3.1.1 Pagesa e tarifave
Pagesa e tarifës së shkollimit **për Ciklin e parë të studimeve** dhe **programin e integruar të studimeve** kryhet **përpara fillimit të sezonit të dimrit**.

Pagesa e tarifës së shkollimit **për Ciklin e dytë të studimeve** kryhet e ndarë në **dy këste**. **Kësti i parë** paguhet **para fillimi të sezonit të provimeve të dimrit** dhe **kësti i dytë** paguhet **para fillimit të sezonit të provimeve të verës**.

3.1.2 Bursat e studentëve
Studentët e institucioneve publike të arsimit të lartë përfitojnë bursa si mbështetje ekonomike për studimet e tyre, si dhe stimuj materialë për rezultate të shkëlqyera. Institucionet e Arsimit të Lartë përcaktojnë në statutet e tyre kritere dhe procedura për shpërblime të studentëve, që përballohen nga vetë institucionet. Me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave konsideron dhe raste të tjera për dhënie bursash, si dhe bursa për studentë të shkëlqyer dhe shkencëtarë.

- **Çdo student që ndjek ciklin e parë të studimeve, me mesatare 6-9 përfiton reduktim të tarifës me 50%.**
- **Çdo student që ndjek ciklin e parë të studimeve, me mesatare 9.0-10.0 nuk paguan tarifë dhe përfiton bursë studentore 10,000 lekë në muaj.**
- **Çdo student që ndjek ciklin e dytë të studimeve, me mesatare 9.0-10.0 përfiton reduktim të tarifës me 50%.**

Bursat për studentët shqiptarë aktualisht ndahen në dy kategori: **bursa për studentët të konsideruar si ekselentë** dhe **bursa për studentët të kategorive sociale**.

Studentët të konsideruar si ekselentë janë ata të cilët e kanë mesataren e vitit paraardhës 9-10. Pra nëse një student është në vit të dytë në Bachelor dhe ka mesataren e vitit të parë 9.5 atëherë ai përfiton bursë ekselence. Për vitin e tretë, si referencë për mesataren do të merret

vetëm viti i dytë, ndërsa për studentët e vitit të parë përdoret mesatarja e gjimnazit (duke përfshirë edhe provimet e maturës). Niveli i bursës për këtë kategori është 10,000 lekë në muaj dhe ofrohet vetëm për muajt e vitit akademik, pra duke mos përfshirë muajt e pushimeve verore.

Kategoria tjetër përfshin **studentët që i përkasin kategorive të ndryshme sociale** si: studentët, familja e të cilëve përfiton ndihmë ekonomike, studentët të cilët i kanë të dy prindërit pensionistë ose njërin prind pensionist dhe prindi tjetër nuk jeton, studentët që kanë përfituar statusin e jetimit deri në moshën 25 vjeç, bashkëshortët që kanë fëmijë dhe janë të dy studentë, përfitojnë secili bursë financiare etj. Edhe në këtë rast niveli i bursës është 10.000 lekë në muaj dhe ofrohet vetëm për muajt e përfshirë në vitin akademik.

Për më tepër, për këtë kategori studentësh, referojuni tabelës së mëposhtme e cila jep informacion për kategorinë ku studentin mund të bëjë pjesë si dhe dokumentat që duhet të dorëzojë për të qenë përfitues i bursës:

Pika	Kategoria	Dokumentacioni i nevojshëm i studentit
i)	Studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike	Certifikatë familjare, kopje kartë indentiteti, Vërtetim nga Njësia administrative vendore që familja e studentit trajtohet me ndihmë ekonomike
ii)	Bashkëshortët që kanë fëmijë dhe janë të dy studentë, përfitojnë secili bursë financiare;	Certifikatë familjare, kopje id, Vërtetim studentit nga institucionet publike IAL
iii)	Studentët, persona me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar;	Kopje kartë indentiteti, Vërtetim i pagesës nga DRSHS, Kopje e vendimit të K.M.C.A.P

iv)	Studentët të cilët kanë të paktin njërin prind me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar.	Certifikatë familjare, kopje kartë indentiteti, Vërtetim i pagesës nga DRSHS, Kopje e vendimit të K.M.C.A.P për prindin.
v)	Studentët që i kanë të dy prindërit pensionistë ose njërin prind pensionist dhe prindi tjetër nuk jeton	Certifikatë familjare, kopje kartë indentiteti, Vërtetim i pagesës së pensionit nga DRSHS,
vi)	Studentët, të tretët në radhën e fëmijëve e lart, të cilët vijnë nga familje me tre fëmijë e më shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë	Certifikatë familjare, kopje kartë indentiteti, Vërtetimi që të dy fëmijët e parë janë studentë në IAL Publike.
vii)	Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç;	Kopje kartë indentiteti, vërtetim të statusit të jetimit.
viii)	Studentët që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykate të formës së prerë, deri në moshën 25 vjeç;	Certifikatë familjare, kopje kartë indentiteti, vendim gjykate të formës së prerë
ix)	Studentët që janë identifikuar si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore, deri në moshën 25 vjeç;	Kopje id, Vërtetim nga Ministria e Brendshme.
x)	Studentët që janë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.	Kopje kartë indentiteti, Shkresa nga Ministria përkatëse.
xi)	Studentët romë dhe egjiptianë, të cilët do të identifikohen nëpërmjet vetëdeklarimit	Kopje kartë indentiteti, Formulari i vetëdeklarimit
xii)	Studentët, fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie."	Certifikatë familjare, kopje kartë indentiteti, vërtetimi nga instituti i të përndjekurve politikë.

*Kategoritë përfituese ose dokumentacioni i nevojshëm mund të ndryshojë sipas VKM-ve përkatëse. Informacione më zgjeruara dhe të përditësuara mund t'i gjeni në zyrën e financës pranë fakultetit tuaj.

04

STUDENT NË UPT

4.1 TË DREJTAT DHE DETYRAT E STUDENTIT

Me rëndësi për çdo student është njohja e të drejtave dhe detyrave të tij, ndaj ky kapitull trajton pikërisht këtë temë. Në vijim do të gjeni një përmbledhje në shërbim e ndihmë të çdo studenti.

Studenti ka TË DREJTË:

- të **përdorë pajisjet e shkollës**, sipas rregullave përkatëse, për të realizuar programin mësimor dhe punën e programuar në aktivitetin e tij shkencor, laboratorët, bibliotekën dhe mjediset sportive e kulturore të Fakulteteve të Universitetit;
- të **organizohet në shoqata të ndryshme** jopolitike dhe joekonomike në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, statutin e Universitetit, aktet ligjore e nënligjore përkatëse.
- të **përfaqësohet në senatin akademik dhe këshillat e fakulteteve** në përputhje me statutin e Universitetit Politeknik
- të **kërkojë respektimin e procesit mësimor** dhe të procedurave siç parashikohen në Statut dhe rregulloren e brendshme të fakultetit.
- të **shprehë opinionet e veta** për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik
- të **ndjekë leksione, seminare/ushtrime** dhe të gjitha veprimtaritë e tjera mësimore të organizuara në përputhje me statusin e tyre.
- të **ankohet në instancat përkatëse** të universitetit për çdo shkelje të të drejtave të tij.
- të **pajiset me kartën e studentit**, e cila është një dokument unik me anë të së cilës studentët përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara. Kriteret dhe procedurat për përgatitjen dhe lëshimin e kartës së studentit përcaktohen nga MASH. Kategoritë e shërbimeve, që ofrojnë entet shtetërore bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me marrëveshje me organizma që kanë objekt të tyre interesat studentore dhe me persona juridik privat që ofrojnë shërbime të ndryshme.

Studenti është I DETYRUAR:

- të **njohtë me hollësi rregullat e shkollës**, e detyrimet e tij dhe të jetë i vetëdijshëm për zbatimin e tyre; në të kundërt, shkolla nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e tyre.
- të **zbatojë të gjitha rregullat që rrjedhin nga Statuti i Universitetit Politeknik**, nga kjo Rregullore dhe nga çdo akt tjetër ligjor e nënligjor për Arsimin e Lartë.
- të **shlyejë të gjitha detyrimet e përcaktuara** në planin mësimor dhe programet e lëndëve.
- të **mbajë përgjegjësi për shkeljet e rregullave** të shkollës nga ana e tij; dëmi material që ai mund të ketë bërë, zhdëmtohet sipas ligjeve në fuqi.
- të **respektojë etikën e paraqitjes së jashtme** në përputhje me karakterin akademik të Universitetit.
- të ruajë e të **respektojë etikën e sjelljes** me stafin akademik, stafin joakademik, stafin e shërbimit, me studentët e tjerë, në mjediset e Universitetit, në orët e mësimin, në praktikat mësimore dhe në çdo aktivitet tjetër të organizuar nga Universiteti.
- të ruajë e të **respektojë papekshmërinë e orës së mësimin** dhe të pedagogut në mësim.

Studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës janë përgjegjës për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e këtyre detyrimeve.

4.2 KARTA E STUDENTIT

Studentët e institucioneve publike e private të arsimit të lartë pajisen me kartën e studentit, e cila është dokument unik. Me anë të saj studentët përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara në transport publik, muze, teatro, galeri, kinema, biblioteka, rrjete kafenesh, qendra tregtare etj. Ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit përcakton kriteret dhe procedurat për përgatitjen dhe lëshimin e kartës së studentit.

Përfitimet e studentëve nga përdorimi i kartës së studentit përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit të ministrisë përkatëse që mbulon Institucionin e Arsimit të Lartë ose njësitë të qeverisjes vendore që mbulojnë shërbimet e ofruara ndaj studentëve.

Kategoritë e shërbimeve që ofrojnë entet shtetërore bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me marrëveshje me organizma që kanë objekt të tyre interesat studentorë e me persona juridikë privatë që ofrojnë shërbime të ndryshme.

Për të **aplikuar për Kartën e Studentit** kërkoni më shumë **informacion pranë Zyrës së Karrierës të Fakultetit tuaj**.

Për më shumë informacion
skanoni kodin ose vizitoni:
<https://www.kartaestudentit.al/>



Aplikacioni **Karta e Studentit**
mund të shkarkohet falas në
AppStore.



4.3 REZIDENCAT STUDENTORE NË TIRANË

Rezidencat shtetërore studentore në Tiranë kanë një kriter pranimi në bazë të universitetit që studenti ndjek. Nëse në këto rezidenca ka vende vakante pas një date të caktuar (që afishohet nga institucioni përkatës) mund të bëjë regjistrimin çdo student edhe nëse nuk është në listën e përparësisë së rezidendave.

Zyrat e karrierës në fakultete ndihmojnë studentët me procesin e akomodimit dhe integritet të tyre.

Dokumentacioni i nevojshëm për t'u regjistruar:

- Mandati i pagesës
(tek BKT, Credins ose Tirana Bank - për vitet e para)
- Fotografi (4 copë)
- Fotokopje e ID-së
- Vërtetim nga Universiteti
- Raporti Mjeko-Ligjor



Rezidenca studentore 1

✉ rsu.drejtoria@gmail.com,
rsu.drejtoria2@gmail.com

☎ +355 69 27 63 497
+355 69 42 92 229

1



Rezidenca studentore 2

✉ drejtoria2@gmail.com

☎ 04 224 04 09

2

Rezidenca studentore universitare Nr.1 (Qyteti Studenti) ka si përparësi të regjistrojë studentë nga Fakulteti Ekonomik, Fakulteti Filologjik, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Universiteti i Arteve.

Rezidencat me pagesë vjetore 45,000 Lekë përfshijnë dhoma me 1 shtrat, dhoma me 2 shtretër ose dhoma me 3 shtretër. Tualetet dhe dushet janë të përbashkëta dhe energjia elektrike + uji i pijshëm të garantuar (i përfshirë në pagesë). Shërbimi i lavanderisë është me pagesë shtesë, dhe mandati tërhiqet pranë arkës në Drejtorinë e Rezidencës Studentore, me vlerën 130 Lekë.

Rezidenca Nr. 6 me pagesë vjetore 50.000 Lekë

Rezidencat Nr. 11-12 me pagesë vjetore 55.000 Lekë

Rezidencat 1 dhe 13, me pagesë mujore 10.000 lek në muaj (+5.000 lekë siguracion, të cilat rikthehen në zgjidhjen e kontratës, nëse studenti nuk dëmton bazën materiale)

Godinat përfshijnë dhoma me 2 shtretër + tualet + kabinë dushi, energji elektrike + ujë të pijshëm (të përfshirë në pagesë). Shërbimi i lavanderisë është me pagesë shtesë.

Rezidenca studentore universitare Nr. 2 pranë Inxhinierisë së Ndërtimit (Rruga "Artan Lenja") ka përparësi të regjistrojë studentë nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Arkitekturës, Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Fizike, Universiteti i Sporteve, Fakulteti i Shkencave Sociale.

Rezidenca me pagesë vjetore 63 000 lekë + 2000 lekë siguracion për mirëmbajtjen e ambientit të cilat rikthehen në zgjidhjen e kontratës)

Godinat A - B - C janë funksionale dhe ofrojnë të njëjtat kushte: dhoma me 2 shtretër, dhoma me 3 shtretër si edhe energjia elektrike + uji (24 orë) të përfshira në pagesë.



Rezidenca studentore universitare Nr. 3
pranë Universitetit të Mjekësisë ka si përparësi të regjistrojë studentë nga Universiteti i Mjekësisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës.

Të drejtat dhe detyrimet e studentëve në Rezidencën Studentore Universitare (RSU)

Studenti i akomoduar në Rezidencën Studentore Universitare e fiton cilësinë si i tillë me regjistrimin në Drejtorinë e Shërbimeve Studentore.

Studentët kanë TË DREJTË:

- Të pajisen me **kartën e studentit**;
- Të **shprehin opinionin e tyre** për cilësinë e shërbimit dhe punën e personelit të RSU-së;
- Të **përdorin bibliotekat dhe mjediset sportive, kulturore e informative** të RSU-së;
- Të **zgjedhin dhe të zgjidhen në këshillat e studentëve**;
- Të **zgjedhin përfaqësinë studentore** nga të cilat përftohet Këshilli i Përfaqësisë Studentore të Rezidencës;
- Kur plotësojnë kushtet e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, të përfitojnë **bursë studimi** dhe shpërblime e çmime të veçanta për merita studimi e kërkimi shkencor që administrohen nga universiteti;
- Të **organizohen në shoqata studentore** jopolitike duke ju përmbajtur përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore përkatëse;

Studentët kanë DETYRIM:

- Të **zbatojnë detyrimet** që rrjedhin nga Statuti, Rregullorja e universitetit, rregulloret e brendshme të fakulteteve, si dhe çdo akt ligjor apo nënligjor për arsimin e lartë;
- Të zbatojnë të gjitha **detyrimet që rrjedhin nga planet dhe programet mësimore**;
- Të **paguajnë tarifën e shkollimit** dhe të shërbimeve që ofron universiteti;
- Të **respektojnë kodin e etikës** të miratuar nga Këshilli i Etikës;
- Të **respektojnë të drejtat e personelit akademik, ndihmës mësimor-shkencor, dhe administrativ** si dhe të studentëve të tjerë;

Mosrespektimi nga ana e studentit, i detyrimeve të përcaktuara në këtë statut dhe në rregulloren e fakulteteve ndëshkohet me masa disiplinore.



4.4 BIBLIOTEKAT E QYTETIT TË TIRANËS

Studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës mund të frekuentojnë edhe biblioteka të tjera në qytetin e Tiranës, krahas Bibliotekave të Fakulteteve të tyre si edhe Bibliotekës Shkencore.

Bibliotekat publike të qytetit të Tiranës janë hapësira leximi e studimi, por edhe qendra me natyrë sociale, ku mjaft studentë e të rinj mund të takohen për të studiuar bashkë apo për t'u përgatitur për sezonin e provimeve.

Për të **aplikuar për anëtarësim** në Bibliotekat Publike të qytetit të Tiranës, studentët nevojitet të paraqesin dokumentet si më poshtë:

1. Fotokopje të kartës së studentit
2. Fotokopje të ID-së ose pasaportës
3. Foto personale
4. Adresën e banimit

Biblioteka "Moikom Zeqo",
Rruga "Tefta Tashko Koço"

Biblioteka nr. 10,
Rruga "Aleksandër Moisiu", Kinostudio

Biblioteka nr. 6,
Rruga "Llazi Miho", Pallati 159

Biblioteka "Musine Kokalari",
Bulevardi "Gjergj Fishta"

Biblioteka " Hamit Beqja",
Rruga "Thanas Ziko", Nd. 57,H.3

Biblioteka "Petro Zheji",
Rruga "Petro Marko"

Biblioteka "Misto Treska",
Rruga "Mine Peza"

Biblioteka nr. 7,
Rruga "Lord Bajron"

Për më shumë informacion
skanoni kodin ose vizitoni:
<https://bibliotekat.tirana.al/>



4.5 SPORTET NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK

Universiteti Politeknik i Tiranës ka Shoqatën Sportive Studentore të tij, të miratuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë Vendim Nr. 5674 që prej datës 02/11/2017.

Aktiviteti sportiv i Universitetit Politeknik të Tiranës filloi në nëntor 2016, në Lojërat Studentore që u zhvilluan në nivel universitetesh publike dhe private, duke zënë vendin e dytë në disiplinën e Basketbollit. Pas krijimit të Shoqatës Sportive, Universiteti Politeknik i Tiranës merr pjesë në Kampionatin Kombëtar Studentor, që organizohet rregullisht çdo vit akademik nga Federata Shqiptare e Sportit Universitar në 4 disiplina: Volejbolli/Femra, Minifutbolli/Meshkuj, Basketbolli/Meshkuj dhe Futbolli/Meshkuj.

Ekipi i Basketbollit Meshkuj i Universitetit Politeknik të Tiranës 2018 – 2019, koordinuar nga Federata Shqiptare e Sportit Universitar, mori një ftesë për takim miqësor në Zagreb me Universitetin e Zagrebit, duke bërë një përfaqësim dinjitoz.

Nëpërmjet zhvillimit të sportit universitar synohet të rriten ambiciet dhe mundësitë në lëvizjen sportive universitare për studentët dhe shoqërinë, duke kombinuar zhvillimin intelektual dhe fizik, për të inkurajuar integrimin e studentëve në sport, edukimin e tyre përmes sportit si dhe për të ndërtuar marrëdhënie të ngushta miqësore në bashkësinë universitare shqiptare nëpërmjet sportit të integruar me arsimin.

Për më shumë info për sportet në UPT na shkruani në adresën e emailit: tspahiu@upt.al



4.6 TRANSPORTI PUBLIK NË TIRANË

Në këtë kapitull do të gjeni disa informacione kryesore mbi linjat e transportit urban të qytetit të Tiranës.

Bileta e transportit urban të qytetit kushton **40 lekë**

Aboneja e studentit kushton **600 Lekë**. Aboneja e studentit përfitohet **falas me Kartën e studentit**.

Aboneja e përgjithshme kushton **1600 Lekë**

Linjat kryesore të transportit urban qytetas:

- Selitë-Kristal-Qendër-Stacioni i Trenit-Allias
- Qyteti Studenti-Jordan Misja

- Teg-Sauk i Vjetër-Kopshti Zoologjik-Ish Stacioni i Trenit
- Mateniteti i Ri- Qendër-Ish Fusha e Aviacionit
- Kashar-Yzberisht-Qendër
- Porcelan
- Qendër-QTU-Megatek-City Park
- Uzina Dinamo e Re-Sharrë
- 5 Maji-Sharrë
- Ish Kombinati i Autotraktorëve-Institut
- Tirana e Re
- Laprakë
- Unaza
- Tufina
- Kombinat-Kinostudio
- Ish Stacioni i Trenit-Qendër-Sauk i Ri/ Sauk i Vjetër/ Sanatorium-Teg

TERMINALET E AUTOBUSËVE NDËRQYTETËS

Terminali i Autobusëve Veri-Jug

Mbikalimi i Kamzës, pranë "Casa Italia"-s

Terminali Lindor i Autobusëve

Lundër, pranë Qendrës Tregtare TEG

Për më shumë informacion për linjat e transportit urban në qytetin e Tiranës skanoni kodin ose vizitoni:
<https://tirana.al/pikat-e-interesit/linjat-urbane>



05

PLATFORMAT ONLINE

5.1 PLATFORMAT ONLINE

Gjatë periudhës së pandemisë Universiteti Politeknik i Tiranës u përshtat me mënyrën e zhvillimit të mësimin online. Si fillim u përdorën platforma të ndryshme si **Classroom**, **Zoom**, **Google Meet** dhe **Microsoft Teams**.

Në pjesën të madhe të fakulteteve përdoret platforma **Microsoft Teams**. Në momentin e regjistrimit në universitet studentit pajiset me një e-mail në formatin *emër.mbiemër@(...).edu.al**

* në email vendosen inicialet e emrit të fakultetit psh. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit = fin


Microsoft Teams

Sipas klasave të ndara nga sekretaria mësimore secili pedagog formon klasat e leksioneve dhe seminareve sipas lëndëve përkatëse. Në secilën klasë studenti ka aksesin të përdorë materialet e hedhura nga pedagogu në seksionin "Files"


Platforma mundëson krijimin e një grupi "team" të pavarur nga stafi pedagogjik dhe hapjen e një video konference me numër të palimituar pjesëmarrësish, pa limit kohëzgjatjeje.

Platforma Microsoft Teams është e aksesueshme nga PC, laptopi, iPad-i, apo smartphone dhe jep mundësinë e kontaktit privat me çdo përdorues tjetër të këtij aplikacioni.

Hapat që duhen ndjekur për të shkarkuar aplikacionin Teams:




1. Në browser hapim adresën **www.office365.com** dhe logohemi me account-in e-mail të hapur nga universiteti. *emër.mbiemër@fti.edu.al*




2. Ndrishojmë Password e e-mail sipas udhëzimeve të aplikacionit



3. Futemi në Teams duke klikuar në ikonën e saj.



5. Mund të shkarkojmë aplikacionin në PC, laptop, iPad, smartphone nëse dëshirojmë




Platforma E-Learning FAU

Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës përdor një platformë tjetër për të lehtësuar komunikimin midis stafit akademik, administrativ dhe studentëve, e cila quhet **e-learning FAU**.

Për të aksesuar platformën e-learning FAU klikoni në linkun **<https://fau.easy-web.cloud>** dhe identifikohuni duke përdorur kredencialet që ju janë dërguar me email.

Për çdo mangësi apo pasaktësi që mund të vëreni në lidhje me lëndët dhe listën e studentëve mund të kontaktoni me sekretarinë e fakultetit. Për çdo problematikë që mund të hasni në përdorimin e platformës ju lutemi të kontaktoni me ekipin mbështetës të platformës nëpërmjet email-it **eni.goxhaj@fau.edu.al**



Platforma Bit-Albania

Bit Albania është një platformë online në shërbim të studentëve të 6 prej njësive të Universitetit Politeknik të Tiranës, përkatësisht: Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave dhe Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike.

E lidhur me Sekretarinë Mësimore të secilit nga Fakultetet e mësipërme, kjo platformë jep informacion për detyrimet dhe notat e marra gjatë sezonit të provimeve.

Për të aksesuar platformën klikoni fillimisht **<https://bit-albania.com/>** e më pas mbi logon e Universiteti Politeknik. Më pas, klikoni mbi fakultetin përkatës, dhe logohuni fillimisht duke vendosur emrin dhe mbiemrin, si jeni regjistruar në sekretarinë mësimore. Platforma do t'ju japë informacion për detyrimet para sezonit të provimeve, dhe notat e provimeve që keni dhënë.



KONTAKTE TË RËNDËSISHME

Në jetën e përditshme secili nga ne mund të përballlet me probleme apo ngjarje të papritura, ndaj këtu po grupojmë disa kontakte të rëndësishme:

QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE NËNË TEREZA

+355 4 2349233 (për Tiranën)

URGJENCA

+355 4 2222235 (për Tiranën)

REZERVIMET E KONSULTAVE AMBULATORE

0800 28 28

+355 4 2349217 (për Tiranën)



QENDRA E
EMERGJENCËS

112



POLICIA

129



ZJARRFIKËSJA

128



AMBULANCA

127

KONTAKT

Universiteti Politeknik i Tiranës

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",
Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 227 81 59

Email: info@upt.al



www.upt.edu.al

Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",
Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri

Email:

abeqo@upt.al

rkodra@upt.al

Zyra e Karrierës dhe Alumni

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",
Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri

Email: zyraekarrieres@upt.al



Universiteti Politeknik i Tiranës



9 789928 481443